

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Revanshi": Shtatë të pandehur dënohen me 50 vjet burg - Reporter.al
ADRESA	https://www.reporter.al/2026/09/15/revanshi-shtate-te-pandehur-denohen-me-50-vjet-burg/
BURIMI	reporter.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 10:57:34 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 1800 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 10:51:14 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	81168fa05cd156bbba5f3c5248d4dc78da36c2069be32787b490cc69a8e22505
TEKSTI	53a74f0f62675c581beba3ec035f55828636ed2c901c1e920d94b664377bcf2a
PAMJA	6a233733678673f9d1e994109a164b3a845a863d62a7208a422fc318c50fb652

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9f247e79e0000f58437a1e4615b1a98fd70c3fe0e4a1a6d88f675a900b8ac2ec
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	93a0feb7bb19154a540f480bce1eeee0b2224e0180d4198842f090d06654d15a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9f247e79e0000f58437a1e4615b1a98fd70c3fe0e4a1a6d88f675a900b8ac2ec>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TEMA:

BELINDA BALLUKU

ERION VELIAJ

VETING

SPAK

MJEDISI

EDI RAMA

SALI BERISHA

ZGJEDHJE 2025

Kryefaqja Lajme

“Revanshi”: Shtatë të pandehur dënohen me 50 vjet burg

Durim Bani, ish-drejtori Policisë Lezhë, Henerigert Mitri dhe pesë persona të tjerë të pandehur në dosjen e quajtur “Revanshi”, u gjetën fajtorë për shumicën e akuzave të ngritura ndaj tyre dhe u dënuan në total me 50 vjet heqje lirie.



nga Edmond Hoxhaj — 1 minute më parë në Lajme Koha e leximit: 2 min lexim

AA

0



Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë deklaroi fajtorë për shumicën e akuzave shtatë prej të pandehurve të dosjes së quajtur “Revanshi”, të cilët u gjykan me procedurë të shkurtuar dhe veçmas 20 të pandehurve të tjerë, të cilët u dërguan për gjykim nga SPAK nëntë muaj më parë. Të dhënat e Sky ECC zbuluan atentatet dhe planet për vrasje mes dhjetëra anëtarëve të krimit të organizuar, mes të cilëve dhe ish-deputeti socialist, Arben Ndoka, si dhe përfshirjen e zyrtarëve më të lartë të Policisë së Shtetit në zonën e Lezhës, në kultivimin e bimëve narkotike.

Shtatë të pandehurit e kësaj çështjeje penale që u gjykan me procedurën e shkurtuar janë, Durim Bani, Jozi Kraja, Aldo Avdyli, Oltion Zefi, Edson Jozëik, Altin Morina dhe ish-drejtori i Policisë së Lezhës, Henerigert Mitri.

Trupi gjykses i përbërë nga gjyqtaret Alma Kodraliu, Engjëllushe Tahiri dhe Rudina Palloj shpalli vendimin të hënën më 14 shtator, kur vendosi deklarimin fajtor të të pandehurit Durim Bani për sigurim të kushteve dhe mjeteve për vrasjen e Arben Nokës, për grup të strukturuar kriminal në dy raste dhe kultivim të bimëve narkotike e kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit. Në bashkim të dënimeve u caktua masa me 16 vjet burg që në aplikim të gjykimit të shkurtuar reduktohet në 10 vjet e 8 muaj heqje lirie.

Ndërkohë, i pandehuri Durim Bani u deklarua i pafajshëm për sigurim të kushteve dhe mjeteve materiale për të kryer vrasjen e shtetasve Tori Xhecula dhe Erigers Mihasi.

Jozi Kraja dhe Aldo Avdyli, të akuzuar për sigurim të kushteve dhe mjeteve për vrasjen e Durim Banit dhe Valter Banit dhe kryerje të veprave penale nga organizata kriminale e grupi strukturuar kriminal, u deklaruan fajtorë për këto vepra penale dhe në aplikim të gjykimit të shkurtuar, u dënuan përfundimisht me nga 4 vjet e 8 muaj burgim secili.

Oltion Zefi, i pandehur për trafikim të narkotikëve dhe grup i strukturuar kriminal u dënua përfundimisht me 10 vjet burg. Për të njëjtat vepra penale u gjet fajtor dhe i gjykuari Edson Jozëik, ndaj të cilit u caktua masa me 8 vjet heqje lirie.

Ish-drejtori i Policisë së Lezhës, Henerigert Mitri u dënua me 5 vjet e 4 muaj burgim për kultivim të bimëve narkotike në formën e grupit të strukturuar kriminal, për grup të strukturuar kriminal dhe shpërdorim detyre.

Gjykata deklaroi fajtor të pandehurin Altin Morina për kultivim të bimëve narkotike, të kryer në formën e grupit të strukturuar kriminal; për grup të strukturuar kriminal dhe mbajtje pa leje të armëve e municionit. Ndaj, tij u caktua masa përfundimtare e dënimit me 6 vjet e 8 muaj burgim.

Për këtë të pandehur, trupi gjykses vendosi të pushojë një akuzë të dytë të ngritur për mbajtje pa leje të armëve dhe municionit luftarak.

Etiketa: Altin Morina Dosja Revanshi Durim Bani Gjykata e Posaçme Henerigert Mitri

“Revanshi”: Shtatë të pandehur dënohen me 50 vjet burg

12:51 | 15/09/2025

Gjykata e Lartë lë në fuqi arrestin me burg për Erion Veliajn

12:12 | 15/09/2025

E vërteta dhe pasojat: Gjykata Speciale e Kosovës drejt një vendimi me rëndësi vendimtare

11:17 | 15/09/2025

Konflikti për pagat, një kapitull i ri i përplasjeve të Ramës me drejtësinë

08:19 | 15/09/2025

Gazetari Osman Stafa kërcënohet sërish me jetë

17:57 | 14/09/2025

AGSH padit në Gjykatën Kushtetuese rregulloren e brendshme të GJKKO

17:00 | 14/09/2025

Opinion

Reportazhe

Analiza

Investigime

Lajme

Blog

Rajoni

Recension

Stafi

Kontaktimi

Ankesa dhe Korrigjime

Politika e privatësisë dhe
rregulla të tjera

Letra për redaktorin

Follow Us



Të gjitha të drejtat janë të rezervuara

© 2014 - 2026 Reporter.al - BIRN

Dev by Slida.PRO

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.